

Mr. sc. Zelijë SHALA

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës

RIORGANIZIMI I MATERIALIT ARKIVOR NË DEPO TË ARKIVIT SHTETËROR TË KOSOVËS

***Përmbledhje:** Dokumentet arkivore, që janë dorëzuar në Arkivin e Kosovës gjatë periudhave të ndryshme nga institucionet, nga organizata apo individë të caktuar, janë sistemuar në depon e arkivit, ashtu siç e kanë vlerësuar udhëheqësit e institucionit. Në shumë raste është bërë edhe ndarja e fondeve duke i vendosur nëpër vende, gjoja “përkohësisht” apo në mungesë të hapësirës. Herë pas here kemi organizuar punëtori të ndryshme me qëllim për sistemimin e tyre të përshtatshëm, njëkohësisht për ta bërë më të qasshme jo vetëm punën e personelit brenda këtij institucioni, por edhe të ofrojmë shërbim sa më cilësor për hulumtues në fusha të ndryshme shkencore. Si i tillë, Arkivi i Republikës së Kosovës, në kuadër të trendëve të zhvillimit dhe modernizimit, e ka të domosdoshme që, përveç sistemimit dhe ruajtjes së të dokumenteve, të kalojë tashmë në fazën e digjitalizimit. Ndaj, për të arritur deri te ky nivel, në kuadër të këtij punimi unë do ta shtjelloj tezën e riorganizimit, sistemimit dhe nevojën e digjitalizimit të dokumenteve arkivore.*

Fjalë kyçe: Dokumentet arkivore, fondet, koleksionet, rregullimi, digjitalizimi

REORGANIZATION OF ARCHIVAL RECORDS IN THE REPOSITORY OF KOSOVO STATE ARCHIVES

***Abstract:** Archival records, which have been submitted to the Kosovo Archive during different periods by certain institutions, organizations or individuals, have been systematized in the archives repository as assessed on the spot by the leaders of the institution. In many cases, archival fond shave been al located by placing them in, allegedly “temporarily” places or due to lack of space. From time to time we have organized various work shops in order to make their organization adequate, at the same time to make more accessible not only the work of the staff with in this institution, but also the highest quality service for researchers in various scientific fields.*

As such, the Archives of the Republic of Kosovo, in the frame work of development and modernization trends, consider it necessary, in addition to systematization and storage of records, to move to the digitalization phase. There fore, to reach this level, in the frame work of this paper I will discuss the thesis of reorganization, systematization and the need for digitalization of archival records.

Keywords: Archival records, founds, collections, adjustment, digitization

Meqenëse dokumentet arkivore cilësohen si pasuri shtetërore publike, institucioni ynë ka obligim ta bëjë të pamundurën për t'i krijuar kushtet e përshtatshme për ruajtjen dhe sigurimin e këtij materiali. Në kuadër të kësaj, gjatë vitit 2019 raftet metalike u zëvendësuan me rafte lëvizëse. Si pasojë, të gjitha dokumentet u zhvendosën në dysheme, saqë përdorimi i shprehjes “të kërkosh gjilpërën në kashtë” u bë më i duhuri. Prandaj, ishte e nevojshme të bëhej riorganizimi i tërësishëm i fondeve dhe koleksioneve në depon e arkivit shtetëror, shifra e të cilave arrin numrin 662 deri në janarin e vitit 2020. Qëllimi i këtij angazhimi ishte sistemimi dhe rregullimi i fondeve dhe koleksioneve ngaqë pranimi i tyre ndër vite ishte bërë pothuajse për t'i marrë dokumentet në pronësi me qëllim që të mos zhdukeshin ose dëmtoheshin atje ku ishin. Pra, të habitë fakti përse nuk janë vendosur që në fillim si tërësi dhe të pandara në depo.

Megjithëse në kohën e administrimit serb 1990-1999 është bërë ndarja e fondeve, kur janë plaçkitur një pjesë e Fondit të Reformës Agrare, Sekretariati i Punëve të Brendshme, Dosje Personale e projekte të institucioneve shtetërore, por edhe në fonde të tjera, të cilat ende nuk janë përpunuar, ka gjasa që të mungojnë. Por, këtë mund ta vërtetojmë vetëm pasi ta përfundojmë procesin përpunimit të fondeve. Kemi rastin tjetër, p. sh., kur është pranuar fondi i Kuvendit të Krahinës Autonome të Kosovës në dy faza, në vitin 1979 është pranuar me procesverbal, kurse në viti 2000 pa procesverbal.¹ Mendohej se ishte i tëri, por doli e kundërta. Është bërë sistemimi i këtij fondi, por gjatë hulumtimit të palës konstatojmë se disa procesverbale të seancave të Kuvendit të vitit 1985 mungojnë.

Kundër vullnetit tonë ka vazhduar avazi i vjetër gjatë pranimi të fondeve të reja si, p. sh., nga Gjykata Ekonomike, Habitati, oficerët e TMK-së etj., detyroheshim që t'i vendosnim fondet aty ku kishte hapësirë të mjaftueshme. Pra, ne u detyruam ta vazhdonim praktikën e mëparshme që ishte praktikuar në depo. Gjatë punës për zhvendosjen e dokumenteve nga një kat në katin tjetër ose nga një raft lëvizës në raftin tjetër, hasnim në vështirësi të tilla si, p. sh., kishte raste kur nuk lexohej shkrimi në etiketa që herë ishte i shkruar me shkrim dore, herë në alfabetin cirilik dhe herë tjetër me makinë shkrimi, dhe që, me kalimin e kohës dhe depërtimin e dritës, shkrimi ishte shlyer. Do të përmend këtu disa raste që dallojnë nga njëri-tjetri, si: Fondi i Jurisprudencës ishte në të njëjtin kat, por i ndarë në dy pjesë, i cili u bashkua vetëm në aksionin e fundit. Ndërsa fondi i Këshillit Ekzekutiv ka qenë i ndarë në katër vende dhe kate të ndryshme si, p. sh., dosjet e punëtorëve kanë qenë në bodrum dhe është bashkuar në katin e dytë aty ku ka pasur më herët një numër të konsiderueshëm të fondit, ndërkohë që gjatë sistemimit të tyre nëpër rafte, disa dokumente të këtij fondi janë gjetur te gazetatat e shtypit të përditshëm serb dhe turk.

¹ Arkivi Kombëtar i Kosovës, *Udhërrëfytyesi i Fondeve dhe Koleksioneve Arkivore*, vëllimi i parë, Prishtinë, 2002, f. 69.

Në vazhden e kësaj, kemi vepruar njëjtë edhe me Gjykatën e Qarkut të Prizrenit nga viti 1918-1964, të cilën e kemi vendosur në katin e parë, një kat më sipër, pasi që për këtë fond nuk kemi pasur shumë kërkesa nga palët për hulumtim dhe e kemi zëvendësuar me një fond tjetër të cilin e kërkojnë më shumë qytetarët për hulumtim. Këtë e kemi bërë me qëllimin e vetëm që t'ia lehtësojmë punën vetes.

Përkundër faktit që kemi ndërmarrë aksione (punëtori) të tilla edhe në vitet e mëparshme për bashkimin e fondeve, nuk mund të themi se kemi pasur sukses plotësisht, pasi pritëshin kohë pas kohe për shkaqe subjektive. Për shembull, siç na ka ndodhur në angazhimin e vitit 2009, kur u përpoqëm të bënim riorganizimin e fondeve që posedonim, mirëpo puna jonë mori kah krejtësisht tjetër, pasi drejtori i departamentit më shumë e përqendroi vëmendjen tek estetika sesa tek ajo që ishte edhe synimi ynë. Një nga vendimet e tij ishte që të hidheshin të gjitha librat në gjuhën serbe, me arsyetimin se tani më janë “de mode.....” dhe se ne nuk jemi bibliotekë që t'i ruajmë ose, rasti tjetër, kur thoshte se nuk kemi pse t'i ruajmë fondet personale në dorëshkrim që ishin pranuar jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Gjatë pranim-dorëzimit të dokumenteve përpilohet procesverbali në të cilin jemi të obliguar t'i japim të gjitha të dhënat në mënyrë të detajuar, që nga titulli etj., dhe gjendja e dokumenteve në të cilën janë pranuar. Kur bëhet dorëzimi i fondeve në arkiva është e obligueshme të silltet, të paktën teknikisht i rregulluar, por në të shumtën e rasteve ne e kemi pranuar të parenditur ose më mirë të themi të paklasifikuar. Kjo mënyrë e pranimi të dokumenteve është bërë për të vetmen arsye, që ato të mos zhduken. Do t'i referohem rastit kur kemi marrë fondin e Kryeministrit, ku shumica e dokumenteve kanë qenë aplikacione pune, ftesa për takime apo kokteje qeveritare. Më e drejtë do të kishte qenë mos t'i pranoni fare, sepse janë tërësisht të padobishme. Pra, këtu ishte e nevojshme që të aplikoheshin metodat e klasifikimit të dokumenteve për asgjësim, e cila është një nga çështjet më komplekse të punës arkivore, por është e domosdoshme të ndiqen parimet, kërkesat dhe normat e posaçme arkivore dhe juridike.² Kështu vepruam para se të merrnim vendim për asgjësimin e fondit të Statistikave të Regjistrimit të Popullsisë dhe Pasurisë, të vitit 1981, vendosëm të ruanim vetëm librat - buletinet, sepse menduam se ishin të mjaftueshme për ta faktuar përbërjen dhe pasurinë e popullsisë që jetonte atëkohë në Kosovë.

Gjatë kryerjes së punëve të riorganizimit kemi hasur nëpër fonde të ndryshme dokumente të dëmtuara në shkallë të lartë, e që janë një numër i konsiderueshëm i tyre si, p. sh., dosjet e të përndjekurve politikë, vendime mbi pronat, vendime të organizatave të ish-krahinës autonome, gazeta, projekte të objekteve me rëndësi të veçantë etj. Një nga projektet e dëmtuara

² Jusuf Osmani, *Arkivistika, teoria dhe praktika* (Prishtinë, 2005), f. 113.

jashtë mase është ai i hotelit “Bozhur” në qendër të Prishtinës, i vitit 1991. Aq i dëmtuar ishte saqë kur e dërguam për konservim dhe restaurim, kolegu specialist deklaroi: “Është shumë i dëmtuar projekti, kështu që në fillim duhet të bëjmë laminimin e tij dhe pastaj duhet t’i vazhdojmë procedurat të tjera, siç janë konservimi dhe restaurimi”. Kështu pra, vetëm mbas një pune të vështirë do të jetë në gjendje të kthehet për shfrytëzim përsëri ky fond.

Ka raste kur dokumentet e dëmtuara qëndrojnë kohë të gjatë pa u shëruar, pasi punonjësit e konservimit-restaurimit nuk mund t’i pranojnë shkaku se u mungojnë materialet e domosdoshme për dokumentet e dëmtuara. Kjo vjen nga neglizhenca e institucionit për të furnizuar me material të nevojshëm. Kështu që, në mënyrë të drejtpërdrejtë i shkatërrojmë dokumentet vetë.

Prandaj, shtrohet nevoja e digjitalizimit të fondeve dhe koleksioneve si tërësi, me qëllim që të ecim në hap me arkivat e avancuara kudo në botë. Digjitalizimi që bëhet aktualisht në arkivin tonë është në bazë të kërkesave ose nevojave të domosdoshme për t’i shpëtuar dokumentet e fondit, të cilat çdo ditë e më tepër po dëmtohen nga faktorë të ndryshëm siç janë ata kimik-biologjikë, lagështia, temperaturat e larta, fatkeqësi natyrore dhe nga vetë faktori njeri i cili nuk i kushton kujdesin e duhur. Kjo nuk krijon mundësinë dhe kushtet e nevojshme për ruajtjen e dokumenteve siç ndodh në të shumtën e herëve, kur i vendosim dokumentet nëpër bodrume ose kthina tepër të papërshtatshme. Kjo ndikon në dëmtimin e shpejtë të dokumenteve ashtu siç ka ndodhur me dosjet e personave të dënuar nëpër gjykatat e Kosovës. Ne kishim një kërkesë nga televizioni shtetëror i Kosovës për të përgatitur një dokumentar, duke u bazuar në dokumentet e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit por që, fatkeqësisht, nuk arritëm të gjenim personin e caktuar, në bazë të regjistrit ku jepet numri i lëndës dhe emri i individit. Dokumenti në fjalë u gjet vetëm mbasi u bë digjitalizimi i një numri të konsideruar të dokumenteve nga kjo gjykatë.

Nga ana tjetër kemi rastin kur është bërë digjitalizimi i dokumenteve osmane që i ka arkivi, në formë donacioni nga Ambasada e Turqisë në Prishtinë, në tetorin e vitit 2014. Ky fond ka 13 kuti, vitet 1806-1920 dhe ka afërsisht 3 000 faqe. Përbërja e tyre është procesverbale, informata për vakëfnamet etj.

Një pjesë e mirë e koleksionit të hartave ushtarake të ish-Jugosllavisë që u digjitalizuan në Agjencinë Kadastrale të Kosovës për t’u shfrytëzuar nga komisioni i formuar për kufirin me Malin e Zi, nga të cilat nuk është sjellë asgjë në arkivin tonë që t’i kemi të gatshme për nevojat tona dhe të hulumtuesve.

Në anën tjetër, përpunimi dhe rregullimi i fondit të ujërave të Krahinës Autonome të Kosovës, me donacion të Kuvendit të Republikës në vitin 2017³, ishte një mundësi e mirë po të angazhoheshin punonjës shtesë për digjitalizimin e dokumenteve të përpunuara.

³ Libri i shërbimit të depos.

Interesimi dhe angazhimi ynë i veçantë për ta pasuruar Arkivin Shtetëror të Kosovës është edhe grumbullimi i dokumentacionit nga veprimtaritë e ndryshme shoqërore e politike të organizuara në diasporën shqiptare. Por deri më tani na janë dhënë shumë pak fonde të tilla, si fondi i “Trepërçindëshit” të Zvicrës, Suedisë, Fondi i “Lidhjes së Tretë të Prizrenit” në Amerikë.

Shpresoj që kemi bërë një punë të mirë, në atë pak riorganizim që ndërmorëm, sepse do ta bëjë më të lehtë qasjen tonë në fonde dhe koleksione për t’u shërbyer personave të interesuar për to. E tërë puna dhe angazhimi ndër vite është bërë me qëllim që depoja të ketë një strukturë funksionale e cila do të shërbejë për nevojat e saj. Megjithatë, mungon harta topografike e cila lehtëson punën orientuese dhe udhëzuese, përkundër faktit që çdoherë stafi udhëheqës i arkivit në periudhat e mëhershme kishte potencuar se do ta përfundojnë hartën topografike⁴, mirëpo edhe sot e kësaj dite nuk ka përfunduar.

Me këtë riorganizim të depos është e domosdoshme që të përpilojmë një udhërrëfyes intern të ri, pasi ai i vitit 2001 nuk na përgjigjet më, pas ndryshimit të vendndodhjes së shumë fondeve nga kati në kat, ose nga pjesa e djathtë në të majtën. Një nga vështirësitë e tjera që hasim gjatë kryerjes së punëve tona është edhe fakti se, Sektori i Përpunimit të Fondeve në të shumtën e rasteve nuk na i dorëzon në mënyrë elektronike listat e brendshme të fondeve, por vetëm kopjen fizike.

Përfundim

Me gjithë vështirësitë dhe problemet që na dilnin vazhdimisht gjatë procesit të riorganizimit të depos jemi përpjekur t’i eliminojmë dhe kemi vazhduar, përkundër faktit se arkivi cilësohet si një nga vendet më të vështira të punës ku i përshtatet krahasimi që i bëhet - minierë, për shkak të pluhurit që kanë dokumentet, mykut, insekteve të dëmshme e kështu me radhë. Duke qenë se kushtet e përshtatshme për ruajtjen e dokumenteve janë parësore, atëherë institucioni ka për obligim që të bëjë të pamundurën për t’i krijuar kushtet e nevojshme. I tërë angazhimi ynë është t’i ruajmë me fanatizëm dokumentet origjinale sepse kjo përbën vetëm një thërrime të vogël, që është argumenti ynë për identitetin tonë kombëtar. Në fund të fundit, kjo është kauza jonë që jemi në arkiv. Pra, e meta jonë e madhe është se nuk kemi arritur t’i vetëdijesojmë sa duhet përfaqësuesit shtetërorë për rëndësinë e arkivave dhe për këtë nuk ka pasur kurrë vëmendjen e duhur udhëheqja shtetërore e Republikës së Kosovës mbi arkivat.

⁴ Fondi i Arkivit të Kosovës, raporti i vitit 1972.



Figura 1, 2, 3: Dokumente të pasistemuara gjatë aksionit të vitit 2019



Figura 4, 5: Puna gjatë aksionit të vitit 2019



Figura 6: Dokumente për konservim dhe restaurim

Bibliografi:

Arkivi Kombëtar i Kosovës, *Udhërrëfyesi i fondeve dhe koleksioneve arkivore*. Vëllimi i parë, Prishtinë, 2002.

Osmani, Jusuf. *Arkivistika, teoria dhe praktika*. Prishtinë, 2005

Libri i shërbimit të depos

Fondi i Arkivit të Kosovës, viti 1972

